




REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 20/15

Nr. i fq. / Br. st -6-

Data: / Datum 29.01.2015

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

---

RREGULLORE  
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN  
E RREGULLORES 01Nr.330/12 TË DATËS 27.12.2012 PËR TARIFA,  
NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE

JANAR, 2015

Bazuar në nenin 12.2 “c, d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41.2 “c, d” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **29 janar 2015** miratoi këtë:

**RREGULLORE**  
**PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES 01 NR. 330/12**  
**TË DATËS 27.12.2012 PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE**

**Neni 1**

Me këtë rregullore ndryshohet dhe plotësohet Regullorja 01 NR.330/12 e datës 27.12.2012 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale me sa vijon:

1.1. Neni 6 me paragrafët 6.1., 6.2, 6.3, 6.4. fshihet dhe riformulohet me sa vijon:

<b>6.1</b>	<b>Taksat/tarifat për lëshimin e certifikatave zyrtare në Drejtorinë për Administratë</b>	<b>Lartësia e taksës</b>
1.1	Lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile	1.00 €
1.2	Vendim për korrigjimin e të dhënave personale ne Regjistra të gjendjes civile	1.00 €
1.3	Vendim për regjistrim të mëvonshëm të lindjes, vdekjes ose anulim të regjistrimit	3.00 €
1.4	Vërtetime, certifikata të ndryshme të palëve që nuk janë të përfshira më lart	1.00 €
1.5	Procedura-ceremonia e kurorëzimit	10.00 €
1.6	Kurorëzim jashtë orarit të punës	20.00 €
1.7	Kurorëzim jashtë orarit të punës dhe jashtë selisë së organit	50.00 €
1.8	Vendim mbi ndërrimin e emrit personal	20.00 €
1.9	Aplikim për fitimin ose lirim nga shtetësia	5.00 €

6.2 Nga taksat për pagesa për shërbimet e kryera nga paragrafi 6.1 pika 1.1 deri tek 1.4 lirohen kategoritë si më poshtë:

- Familjet e dëshmorëve (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët e dëshmorit deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);
- Shfrytëzuesi i ndihmës sociale (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);
- Invalidët e luftës (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);
- Veteranët e luftës së UÇK-së (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);
- Familjet e viktimave të luftës (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);
- Invalidët civil të luftës (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);
- Të burgosurit politikë (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt), pasi që palakërkuesi të paraqesë dëshminë përkatëse mbi statusin përkatës;
- Shurdhmemecët dhe të verbërit;

6.3 Pagesat për shërbimet e kryera bëhen në llogarinë rrjedhëse të Komunës së Vushtrrisë apo drejtpërdrejtë te zyrtari i autorizuar, i cili obligohet që palës t'i jep dëshmi mbi pagesën e bërë.

1.2. Te neni 7 pika 1.9 Bankat dhe Ekspoziturat taksa nga 700,00 € të ndryshohet në **1000,00€**.

1.3. Te neni 7 pika 1.11 Kompanitë e Sigurimeve (Filialet) nga 300,00 € të ndryshohet në **500,00 €**.

1.4. Te neni 7 pikës 1.13 t'i shtohet edhe kjo fjali: **“ndërmarrjet ndërtimore me ndërtime të ulëta dhe individuale ngarkohen me taksë komunale në shumën prej 160 €”**.

1.5. Te neni 7 pika 1,15, ndërmarrjet (**depot**) me material ndërtimor, taksa prej 250,00 € të ndryshohet në **300,00 €**.

1.6. Te neni 7 pika 1.27 pompat e benzinës (të riformulohet) **Pompat e benzinës në qytet dhe përgjatë magjistrales Prishtinë –Mitrovicë**; 500,00 €, si dhe të shtohet fjalia **“Pompat e benzinës në viset rurale” 250,00 €**.

1.7. Te neni 7 pika 1.38 Prerësit e automjeteve të vjetra nga 300,00 € të ndryshohet në **500,00 €**.

1.8. Te neni 7 pika 1.62 Bastoret sportive (**dhe lojërat tjera të fatit**) nga 700,00 € të ndryshohet në **1000,00 €**.

1.9. Te neni 7 nënparagrafi 1.63 “Riparuesit e aparateve TV” të bartet në paragrafin 7.7 (që ka të bëjë me lirim nga taksa komunale).

1.10. Te neni 7 nënparagrafi 2.1 (ortarët) dhe 2.4 (fotografët) të barten në paragrafin 7.7 (që ka të bëjë me lirim nga taksa komunale).

1.11. Te neni 7.1.3 të shtohen dy paragrafë të rinj, pas paragrafit 3.23 me këtë përmbajtje:

**Paragrafi 3.24. Dyqanet e Pavarura Tregtare (DPT), joushqimore ngarkohen me taksë prej 100,00 €, kurse DPT-të ushqimore janë të liruara.**

**Paragrafi 3.25 Përmbaruesit privat të ngarkohen me taksë prej 300,00 €.**

1.12. Te paragrafi 7.4 (Përrjashtim nga paragrafi 7.3 i kësaj rregulloreje bëjnë subjektet afariste që merren me shërbime...), të shtohet **edhe Kompania për furnizim dhe distribuim të energjisë elektrike “KES/CO”, e cila ngarkohet me taksë komunale prej 800.00 €**.

1.13. Kompanitë publike regjionale të cilat janë bashkëaksionare me Komunën e Vushtrrisë, si: KRM ”Uniteti” dhe KRU “Mitrovica” lirohen nga taksa komunale.

## Neni 2

2.1. Te neni 25.3.3 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore (vendosja e rrjetit kabllovik, internet, elektrikë) të riformulohet; **”Shtrirja e rrjetit kabllor nëntokësor elektrik, energjetik, telefonik, optik, internet etj”**, si dhe tarifa nga 2 euro të vendoset në **0.70 €** për meter gjatësi.

2.2. Neni 25, pas nënparagrafit 25.5.3 t’i shtohen edhe tre nënparagrafë të ri:

**25.5.4. “Kur operatori ndërton edhe infrastrukturën nëntokësore tarifa të jetë 2,00 € për metër gjatësi.**

**25.5.5. Shtrirja e rrjetit ajror elektrik, telefonik, telekomunikacion, TV,dhe internet; tarifa të jetë 0.70 € për metër gjatësi.**

**25.5.6. Vendosja e shtyllave elektrike në pronë të komunës 8.00 € për copë.**

2.3. Tarifat nga nenet 26.1, 26.1.1 dhe 26.1.2 të kalojnë si taksë në **Drejtorinë e Shërbimeve Publike.**

2.4. Neni 29.4 të hiqet nga rregullorja.

2.5. Neni 30 të ndryshohet dhe të plotësohet si vijon:

2.5.1. Lejet Mjedisore me listën e aktiviteteve që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale;

### **2.5.2. Grupi i parë – 400 €:**

1. Prodhimi i betonit dhe elementeve parafabrikate, pllakave etj me kapacitet deri në 50 m<sup>3</sup> beton/ditë;
2. Magazinimi i lubrifikantëve të ambalazhuar në vendprodhim;
3. Grumbullimi i mbeturinave të konstruktimit, demolimit etj., për qëllime të riciklimit, përfshirë seleksionimin, copëtimin mekanik dhe deponimin e tyre, si dhe caktimin e vendit për deponim.

### **2.5.3. Grupi i dytë -300 €:**

1. Pikëshitjet e gazit (GLN) deri 4.9 m<sup>3</sup>;
2. Furrat e bukës;
3. Thertore me kapacitet deri 3 gjedhë /ditë;
4. Punishtet e vogla për përpunim të mermerit me sipërfaqe totale-objekti deri në 200 m<sup>2</sup>;

5. Ndërtimi i objekteve të banimit dhe shërbimeve, me sipërfaqe ndërtimi më të madhe se 1000 m<sup>2</sup>;
6. Magazinat frigorifer për produktet ushqimore të ambalazuara me kapacitet total magazinues deri në 50 tonë.

#### **2.5.4. Grupi i tretë- 200 €:**

1. Sharrimi i lëndës drusore;
2. Pikat e magazinimit dhe tregtimit të materialeve të ndërtimit.

#### **2.5.5. Grupi i katërt - 100 €:**

1. Autoserviset;
2. Vendet ku janë të magazinuar më pak se 10 tonë mbeturinë inerte;
3. Vendet ku janë të magazinuar më pak se 2 tonë mbeturinë e parrezikshme;
4. Impiantet për riciklimin dhe prodhimin e masave plastike me kapacitet deri 1000 tonë/vit.

#### **2.5.6. Grupi i pestë - 50 €:**

1. Autolarjet;
2. Magazinimi i plehrave kimike dhe pesticideve me kapacitet magazinues deri në 10 tonë;
3. Qebaporet dhe gjellëtoret;
4. Vendet e tregtimit të kafshëve në ambient të hapur (tregjet tradicionale) ose të mbyllura;
5. Tregjet urbane, industriale dhe të produkteve bimore dhe shtazore.

#### **2.5.7. Grupi i gjashtë – të liruara:**

##### **Projektet Publike**

1. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitimet e tyre në gjatësi deri 5 km;
2. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitim i ujësjellësve ekzistues në gjatësi deri 5 km;

3. Rikonstruksion i rrugëve urbane dhe rurale ekzistuese dhe ndërtim i akseve të reja rrugore (me gjatësi deri në 2 km);
4. Plantacionet e drunjve frutor;
5. Projektet e përmirësimit të pyjeve, pyllëzime, sistemime etj;

### **Neni 3**

Nga taksa në firmë lirohen të gjitha kompanitë prodhuese.

### **Neni 4**

Kjo Rregullore hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

**Shpëtim Zhegrova**  
  
**Kryesues i Kuvendit**

